

KËRKESË
Nr. 196/4, datë 2.6.2015

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve të Brendshme shpall kërkesën për shpronësimin e pasurive të paluajtshme të pronarëve, sipas tabelës bashkëlidhur.

Subjekti kërkuar është Bashkia e Tiranës.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim. Vlera e shpronësimit të pronarëve, për shkak të “Rikualifikimit urban të bllokut nr. 46” të qytetit, në Bashkinë e Tiranës është 6.683.742 (gjashtë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e dyzetë e dy) lekë.

Ky publikim do të jetë për një periudhë 1-javore dhe brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, personat që kanë emrin, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

ZËVENDËSMINISTRI I PUNËVE
TË BRENDSHME
Elona Gjebrea

**Lista emërore e pronarëve, pasuritë e të cilëve do të shpronësohen për rikualifikimin
urban të bllokut nr.46**

Nr	EMER MBIEMER	Zona Kadast.	NR. Pasurisë	Sipërf. Përgj./ m ²	SIP. Tr. të prekur / m ²	Çmimi në lekë	Vlefë në lekë	Konfirm. ZVRPP, Tiranë
1	Bashkpronarët Kamza	8350	2/472	117	117	57,126	6,683,742	nr.prot.5842/1, dt.03.04.2013
					117 m ²	Shuma	6,683,742	